



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument i Komisionit

RAPORT

MBI PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998
“KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

HYRJE

Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 96/2014, ka ngritur një Komision të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë (*këtej e tutje, komisioni i posaçëm parlamentar*) me synim analizën e gjendjes aktuale në sistemin e drejtësisë, përcaktimin e objektivave të reformës në drejtësi dhe propozimin e ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore. Më konkretisht, objekti i veprimtarisë së komisionit përfshin:

- Analizimin e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe diskutim gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, subjektet e tjera të interesuara dhe opinionin publik;
- Hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë;
- Propozimin për miratim të një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke filluar nga rishikimi i dispozitave kushtetuese, të hartuara me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik.

Për realizimin e detyrave të sipërpërmendura, pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar është ngritur një Grup i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i cili mbështetet nga një sekretariat teknik. Këto struktura u ngarkuan me detyrën për të përgatitur një analizë të gjendjes, në të cilën ndodhet aktualisht sistemi i drejtësisë, si dhe të shkaqeve që kanë çuar në këtë gjendje. Në përfundim të fazës së analizës (*faza e parë*), GENL ka përgatitur Strategjinë për Reformën në Drejtësi, në të cilin sugjerohen objektivat e reformës dhe zgjidhjet konkrete për problemet e identifikuara nga kjo analizë (*faza e dytë*). Këto materiale, tashmë të miratuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, kanë shërbyer si bazë për hartimin e projektamendamenteve kushtetuese.

Faza e tretë e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm filloi me punën e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë (vendas dhe ndërkombëtarë) i ngarkuar me detyrën për hartimin e ndryshimeve kushtetuese. Ky grup hartoi projektin për disa shtesa dhe ndryshime kushtetuese, të cilat synojnë reformimin nga pikëpamja institucionale dhe e kompetencave përkatëse të institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë.

A. METODOLOGJIA E PROCESIT TË REFORMËS NË DREJTËSI

Duke vlerësuar rëndësinë e reformës në drejtësi si një reformë në dobi të zhvillimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve, të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së vendit, inicimi i këtij procesi dhe zhvillimi i tij jashtë korpusit ekzekutiv qeverisës, në organin përfaqësues të popullit, në Kuvend, ishte pjesë e një vizioni për procesin e kësaj reforme historike. Mënyra se si u ndërtua Komisioni i Posaçëm Parlamentar me ardhjen e opozitës 9 muaj me vonesë në komision, prej korrik 2015 (barazi në anëtarësi nga maxhoranca dhe opozita) dhe më shumë akoma, procedura e veçantë që u miratua për t'u ndjekur nga ky komision, e konfirmon vullnetin për të pasur një reformë të plotë dhe që mundëson një qëndrueshmëri afatgjatë të saj.

Reforma në sistemin e drejtësisë është e konceptuar mbi 7 shtylla bazë që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend. Prosesi i reformës në sistemin e drejtësisë është ndërtuar në mënyrë të tillë që të respektojë parimet e gjithëpërfshirës, transparencës, profesionalizmit, pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe konsultimit të gjerë midis gjithë aktorëve në këtë proces.

GJITHËPËRFSHIRJA

Tregues i rëndësishëm i gjithëpërfshirës është fakti se grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë i ngritur pranë Komisionit të Posaçëm, përfaqëson institucionet më të rëndësishme të sistemit të

drejtësisë, institucioneve akademike që kontribuojnë në sistemin e drejtësisë, të profesioneve të lira (avokatia, noteria, përmbartimi) si dhe përfaqësuesit e misionëve dhe organizatave e partnerëve ndërkombëtarë.

Ftesës për bashkëpunim të Komisionit të Posaçëm ju përgjigjen pozitivisht Presidenti i Republikës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit Evropian Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Avokatura e Shtetit, Avokati i Popullit, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor etj të cilët janë përfaqësuar me ekspertë në Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik.

Në vijim të një ftese bashkëpunimi të Komisionit të Posaçëm, u krijua Rrjeti i Konsultimit Publik të Profesionistëve pranë Komisionit të Posaçëm, i përbërë nga rreth 1900 persona, përfaqësues të Organizatave Jo-fitimprurëse, gjykatave dhe prokurorive të të tri niveleve, avokatë, profesorë të Fakulteteve të Drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës dhe ekspertë të angazhuar në projekte kërkimore në fushën e drejtësisë.

Për secilën shtyllë të reformës në drejtësi, pranë çdo grupi që u ngarkua me hartimin e projektligjeve më të rëndësishme organike të sistemit të drejtësisë, është ngritur një grup konsultimi i ngushtë *Think Tank* ku janë atashuar gjyqtarë, prokurorë, noterë, avokatë, oficerë të policisë gjyqësore, juristë, etj.

Transparenca dhe konsultimi publik

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të lartë i përfaqësuar nga Institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë dhe misionet ndërkombëtare të Asistencës që operojnë në këtë fushë, ka zhvilluar debate dhe diskutime proaktive, duke mundësuar konsultim të gjerë të produkteve të deritanishëm të kësaj reforme.

Për konsultimin e Analizës së *Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri*, *Strategjisë dhe Planit të Veprimit për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri* dhe projektit të ndryshimeve kushtetuese gjatë vitit 2015, janë realizuar 42 tryeza të rrumbullakëta¹, ku kanë marrë pjesë rreth

¹ 42 tryezat konsultative janë zhvilluar sipas kësaj harta gjeografike: 12 tryeza në Tiranë, 15 tryeza në rrethe, 9 tryeza në Universitete Publike e jopublike në Tiranë e rrethe të tjera, si dhe tryeza bashkëbisedimi në formën e forumeve të hapura publike me ekspertë dhe përfitues të shërbimeve nga sistemi në drejtësi në në qytetet kryesore Shkodër, Vlorë, Durrës, Korçë, Pogradec, Gjirokastër, me pjesëmarrës edhe nga qytetet përreth për të mbuluar gjithë territorin e vendit, (si Tropojë, Dibër, Lezhë, Mat, Pukë, Kurbin, Fier, Kavajë, Krujë, Përmet, Sarandë).

2800 pjesëmarrës dhe kanë kontribuar 400 debatues (gjyqtarë, prokurorë, avokatë, pedagogë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj); janë depozituar në rrugë elektronike dhe nëpërmjet portalit të reformës 100 kontribute me shkrim për këto dokumente si dhe janë zhvilluar debate në median audiovizive.

Në të gjitha veprimtaritë e konsultimit publik morën pjesë dhe ofruan mbështetje për procesin e reformës dhe domosdoshmërinë e saj, partnerët ndërkombëtarë të vendit tonë, Ambasadorja e Delegacionit të BE-së, Ambasadori i SHBA-ve, Ambasadori i Prezencës së OSBE-së, ambasadorë të shteteve të Bashkimit Europian, Zyra e UNICEF në Shqipëri, Zëvendëssekretari i shtetit, në Byronë për Çështjet Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit dhe Narkotikët, pranë Departamentit të Shtetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj.

Rrjeti i konsultimit publik

Rrjeti i konsultimit publik përbëhet nga rreth 1900 persona, nga të cilët 350 gjyqtarë (gjykatat e të gjitha shkallëve), 300 prokurorë, 200 pedagogë të Shkollës së Magjistraturës dhe fakulteteve të drejtësisë private e publike, 800 përfaqësues nga profesionet e lira (noterë, përmbarues, avokatë), 170 ekspertë të pavarur të fushave dhe që i janë përgjigjur thirrjes publike, 30 përfaqësues të organizatave Shoqërisë Civile, 20 përfaqësues nga Institucionet Shtetërore bashkëpunuese në proces.

Kontributet nëpërmjet portalit online dhe postës elektronike

Kanë dhënë kontributet e tyre me shkrim nëpërmjet adresës elektronike dhe portalit online për analizën, strategjinë dhe projektamendamentet kushtetuese, gjithsej rreth 100 persona, nga të cilët 21 gjyqtarë, 10 prokurorë, 15 avokatë, 20 pedagogë, 15 përfaqësues të SHC si dhe të tjerë ekspertë të fushës e studentë të fakulteteve të drejtësisë. Në periudhën nga dita e parë e lançimit të portalit online (8 qershor) deri në fund të muajit dhjetor 2015 kanë qenë rreth 11000 vizita në total në portalin e hapur për transparencën dhe konsultimin publik të reformës në drejtësi.

Përputhshmëria e Reformës me Standardet Ndërkombëtare

Reforma në drejtësi po zhvillohet në përputhje me: a) standardet ndërkombëtare të parashikuara në: *acquis communautaire* të BE-së; b) Konventën Evropiane dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; c) Opinionet e Komisionit të Venecias, si dhe d) dokumente të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtare në fushën e sistemit të drejtësisë.

B. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT

Projektligji sjell ndryshime të rëndësishme në mënyrën e organizimit të organeve të sistemit të drejtësisë dhe kompetencat përkatëse të tyre, duke pasur në vëmendje parashikimin e mekanizmave konkretë që do të rrisin përgjegjshmërinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, si dhe parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit brenda tij.

Projektligji sjell ndryshime në organizimin dhe funksionimin të organeve të sistemit të drejtësisë dhe në disa aspekte të funksionimit të organeve të emërtesës, megjithëse nuk bëjnë pjesë në sistemin e drejtësisë. Projektligji ripërcakton disa nga kompetencat e Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë në procedurat e emërimit të organeve të drejtësisë.

C. PROCESI I HARTIMIT TE PROJEKTLIGJIT

Me vendimin nr.14, dt.30.07.2015 “Për miratimin e Dokumentit ‘Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri’”, Komisioni miratoi, Dokumentin “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, dokument 336 faqe shqip dhe anglisht², i cili përmbyll fazën e I-rë të procesit dhe përbën të parin dokument gjerësisht të konsultuar në publik që analizon mbi baza objektive, shkencore dhe profesionale, nga pikëpamja ligjore dhe zbatueshmërisë së ligjit, gjendjen aktuale të sistemit dhe të gjitha ato problematika aktuale që duhet të adresohen menjëherë, që kanë prekur këtë sistem në drejtim të organizimit, funksionimit, mirëqeverisjes, efijencës dhe administrimit të tij.

Me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 “Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, Komisioni miratoi në parim dokumentin Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë si dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri³, dokumente të cilat përmbyllin Fazën e II-të të procesit dhe që zërthejnë në masa konkrete objektivat strategjike të reformës në sistemin e drejtësisë, duke përcaktuar gjithashtu ligjet të cilat do t’i nënshtrohen ndërhyrjes në fazën e tretë të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm.

Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, vendas dhe ndërkombëtarë, i ngarkuar me detyrën për hartimin e ndryshimeve kushtetuese hartoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Shqipërisë” që synon reformimin e institucioneve kryesore të Sistemit të Drejtësisë nga pikëpamja institucionale dhe e kompetencave të tyre.

² Ky dokument është i botuar në adresën zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë: <http://reformenadretesi.al/dokumenti-analitik>

³ Ky dokument është i botuar në adresën zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë: <http://reformenadretesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>

Bazuar në kërkesën e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për marrjen e opinionit të Komisionit të Venecias lidhur me projektligjin për shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Komisioni vendosi t'i paraqesë Komisionit të Venecias (KV), kërkesën për opinion, lidhur me projektligjin për shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të hartuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë vendas dhe ndërkombëtarë (vendimi nr.17, datë 28.09.2015). Në vijim të vendimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, Kryetari i Kuvendit iu drejtua zyrtarisht Komisionit të Venecias, duke i përcjellë projektligjin e përgatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, si dhe opinionet e grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, kërkoi vlerësimin e tij, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare dhe standardet e vendosur nga vetë Komisioni.

Më datat 2 dhe 3 nëntor 2015, një delegacion i Komisionit të Venecias vizitoi Tiranën dhe u takua me zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të partive politike, gjyqtarë, prokurorë, anëtarë të shoqërisë civile dhe bashkësinë e ekspertëve. Komisioni i Venecias, miratoi opinionin e ndërmjetëm për projekt ndryshimet kushtetuese për sistemin gjyqësor në Shqipëri në Seancën Plenare të 105^{të}, në datat 18 – 19 Dhjetor 2015.

Pas dhënies së opinionit të ndërmjetëm, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë zhvilloi takime/konsulta gjatë të cilave u diskutuan rekomandimet e adresuara nga Komisioni i Venecias në këtë opinion dhe reflektimi i këtyre rekomandimeve në projektin për ndryshimet kushtetuese. Në mbledhjet e zhvilluara nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, morën pjesë edhe ekspertë të grupeve politike parlamentare si dhe ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar, me vendimin nr.18, datë 15.01.2016, vendosi me konsensus që t'i paraqesë Komisionit të Venecias kërkesën për opinion lidhur me tekstin e rishikuar të ndryshimeve kushtetuese të propozuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, mbështetur në opinionin e ndërmjetëm të Komisionit të Venecias, së bashku me opinionet e opozitës, së Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Në datat 21 dhe 22 janar 2016, raporterët e Komisionit të Venecias zhvilluan vizitën e dytë në Tiranë në kuadër të kërkesës për opinion mbi tekstin e rishikuar të projekt amendamenteve kushtetuese. Gjatë kësaj vizite ata zhvilluan një raund të dytë takimesh me aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë, me të cilët diskutuan mbi tekstin e rishikuar të projektit të ndryshimeve kushtetuese të hartuar nga ekspertët e nivelit të lartë, së bashku me opinionet e grupeve parlamentare.

Në datën 26 Shkurt 2016, projekt opinionin përfundimtar i Komisionit të Venecias për projektin e rishikuar të ndryshimeve kushtetuese sipas variantit të datës 15 Janar 2016, i përcjellë me shkresë zyrtare të Kryetarit të Kuvendit në datën 21 janar 2016, ju paraqit sesionit plenar të 106^{të} të këtij Komisioni për miratim. Në seancën plenare të 106^{të}, të mbajtur në datat 11-12 mars

2015, Komisioni i Venecias miratoi opinionin final mbi tekstin e rishikuar të projekt ndryshimeve kushtetuese të hartuar nga ekspertët e nivelit të lartë.

Në paragrafin 11 të Raportit Final të Komisionit të Venecias vlerësohet struktura e organeve të qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë të paraqitur në projektin e ndryshimeve kushtetuese.

Komisioni i Venecias thekson se:

“11. Ka një argument të fortë për ekzistencën e të gjitha këtyre institucioneve. Në përfundim, i takon ligjvënësit kombëtar që të hartojë sistemin e kontrolleve dhe ekuilibrave; një sistem i prekur gjerësisht nga korrupsioni mund të ketë më shumë nevojë për mekanizma kontrolli të jashtëm sesa një sistem më i shëndetshëm. Për ta përmbledhur, Komisioni i Venecias është i përgatitur që ta konsiderojë të pranueshme strukturën institucionale të propozuar ashtu siç është”.

Pas miratimit të opinionit final të Komisionit të Venecias, u zhvilluan 3 mbledhje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për të diskutuar mbi reflektimin e rekomandimeve të Opinionit Final të Komisionit të Venecias në tekstin e rishikuar të projekt të ndryshimeve kushtetuese.

Për komentet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar rreth Projektit të ndryshimeve Kushtetues, më datën 25 prill 2016, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë/ekspertët ndërkombëtarë të EURALIUS dhe OPDAT prezantuan një material me vlerësime/përgjigje mbi çështjet/ pyetjet e ngritura dhe u ra dakord që për këto çështje si dhe çështjet e tjera teknike të adresuara në Opinionin Final, ekspertët t’i paraqesin Komisionit të Posaçëm reflektimet e nevojshme në tekstin aktual të projektit të ndryshimeve kushtetuese.

Mbështetur në opinionin final të Komisionit të Venecias dhe në komentet e bëra gjatë diskutimit të zhvilluar në Komisionin e Posaçëm Parlamentar rreth opinionit final të KV, ekspertët reflektuan ndryshimet e kërkuara në projektin kushtetues dhe në datën 4 Maj 2016 i prezantuan Komisionit të Posaçëm Parlamentar, projektin kushtetues me reflektimet e Opinionit Final të Komisionit të Venecias dhe komentet e propozimet e bëra nga anëtarët e Komisionit.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë zhvilluar seanca konsultimi publik. Kështu, në periudhën nëntor–dhjetor 2015, për konsultimin e projektit të ndryshimeve kushtetuese u zhvilluan 19 tryeza të rrumbullakëta konsultative (4 tryeza qendrore në Tiranë; 6 tryeza rajonale të organizuara në qytetet kryesore të vendit si Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër, Elbasan, Lezhë; 9 tryeza në qendrat kryesore universitare publike dhe jopublike dhe në Shkollën e Magjistraturës) si edhe 2 tryeza bashkëbisedimi me pedagogë të së drejtës dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Më datë 9 Maj 2016, Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi debatin në parim dhe miratoi në parim projektligjin final të projektit kushtetues. Pas miratimit në parim të projektit, në mbledhjet e datave 10, 13, 16, 18, 20 dhe 23 maj 2016, Komisioni zhvilloi debatin nen për nen të projektligjit për ndryshimet kushtetuese, duke bërë një shqyrtim të plotë të të gjithë projektit.

Gjatë diskutimit nen për nen të projektligjit, pati mendime, vlerësime dhe sugjerime nga anëtarë të mazhorancës dhe opozitës në komision. Komisioni sugjeroi propozime të cilat riformuluan disa dispozita të projektligjit dhe kalimin e rregullimeve të detajuara në ligjet përkatëse të organeve kushtetuese. Synimi i këtyre ndryshimeve ishte që ndryshimet kushtetuese të mos mbingarkohen me rregullime të natyrës ligjore. Përmirësime të ndjeshme u kryen në tekstin e propozimeve me qëllim që terminologjia të pajtohej me gjuhën e përdorur në dispozitat e kushtetutës në fuqi.

Për çështje të cilat nuk pati dakordësi dhe që sipas Komisionit të Venecias ishin çështje për vendimmarrje politike, u dakortësua që të lihen të hapura për një diskutim të mëvonshëm.

Në mbledhjen e datës 14 qershor 2016, Komisioni miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke lënë të drejtë komisionit të reflektojë mbi dispozitat që janë pjesë e vendimmarjeve politike.

Bazuar në kërkesat e anëtarë të opozitës në komision, nga projekti fillestar i projektit të ndryshimeve kushtetues, gjatë diskutimit nen për nen u hoqën disa struktura të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përbërja, organizimi dhe funksioni i disa organeve të krijuara me Kushtetutë u ndryshuan, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtarë në këtë proces. Konkretisht:

a) ***Në lidhje me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi***, ishte parashikuar si një organ *ad hoc*, anëtarët e të cilit caktohen për shkak të detyrës (*ex officio*) dhe me një përbërje që ndryshon me përfundimin e mandatit të funksionarëve konkret. Ky organ ishte strukturuar si një organ elitar dhe me përbërje të personaliteteve të drejtësisë, të cilët plotësojnë kriteret më të larta profesionale e morale, sepse janë ata që do të kryejnë verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore profesionale e morale për kandidatët e organeve kushtetuese, si dhe do të bëjnë renditjen e tyre. Vendimi i këtij organi ishte menduar si një mekanizëm ç’bllokues mjaft përcaktues për procesin e konstituimit të organeve kushtetuese.

Bazuar në kërkesat e opozitës dhe diskutimeve në komision përbërja e Këshillit ndryshoi dhe roli i tij pësoi ndryshime sipas propozimeve të bëra nga ekspertët në komision. Për më tepër lidhur me përmbajtjen kësaj dispozite për këtë organ, do të ketë shpjegime të detajuara në vijim.

b) ***Në lidhje me Gjykatën e Lartë Administrative.*** Sistemi i përzier, të cilin e ka pranuar, për fat të keq Shqipëria, rezulton të ketë dështuar. Individët, biznesi dhe vetë administrate publike shpresonin shumë se me krijimin e gjykatave administrative do realizohej “një drejtësi pa vonesa”. Në kushte të tilla u sugjerua një riorganizim i piramidës gjyqësore administrative ashtu si edhe në vendet që kanë krijuar gjykata administrative, ku pranohen disa gjykata administrative në shkallë të parë, një ose disa gjykata administrative apeli dhe një Gjykatë e Lartë Administrative, e shkëputur nga Gjykata e Lartë.

Në versionin fillestar të projektligjit kërkohet të ndahej juridiksioni administrativ, jo vetëm në shkallë të parë dhe në Apel, por edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet krijimit të Gjykatës së Lartë Administrative brenda pushtetit gjyqësor të juridiksionit gjyqësor administrativ nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor; krijimin e Gjykatës së Lartë Administrative, si shkallë e fundit, e cila do të ushtrojë juridiksionin rishikues dhe, për raste të posaçme edhe juridiksion fillestar, përshpejtimin e gjykimit administrativ në të gjithë nivelet si dhe uljen e ngarkesës së GJL, e cila do të merret vetëm me çështjet civile dhe penale.

Ndonëse kjo gjykatë do fillonte të funksiononte në vitin 2020, anëtarët e opozitës në Komision e kundërshtonin atë. Në kuadër të konsensusit politik, gjatë diskutimit nen për nen të projektligjit, komisioni vendosi ta heqë këtë gjykatë nga projekti.

c) ***Në lidhje me Tribunalin Disiplinor të Drejtësisë, ky organ*** që në fillim, është menduar të jetë një organ *ad hoc*, i përbërë në shumicën e tij, me gjyqtarë aktiv, ashtu si edhe me jogjyqtarë. Ky organ ishte kompozuar si organi që do të ushtrojë pushtetin procedues ndaj funksionarëve më të lartë të Drejtësisë, si ndaj anëtarëve të KLGJ, të KLP-së, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pra, ky organ do vendos për shkarkimin e atyre funksionarëve, të cilët sot i vendos politika. Gjatë mbledhjeve të Komisionit të Posaçëm, opozita ka pranuar vlerën e ekzistencës së Tribunalit, por ka shprehur shqetësime rreth korporatizmit dhe konfliktit të interesave në përbërjen e tij.”. Pra, nuk ka rezultuar shkrirja e Tribunalit, si një opsion i mundshëm i opozitës. Por gjatë mbledhjeve të komisionit, opozita theksonte nevojën e parandalimit të korporatizmit dhe kalimin e kompetencave të këtij tribunali Gjykatës Kushtetuese. Përfaqësuesit e opozitës në komision nuk ishin dakord me përbërjen e Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë, pasi sipas vlerësimit të tyre përbërja e propozuar linte shteg për korporatizëm, për abuzime si dhe anëtarët e TDD-së mund të kenë konflikt interesi. Në kuadër të konsensusit politik, gjatë diskutimit nen për nen, komisioni vendosi ta heqë këtë organ nga projekti. Për më tepër lidhur me organin që do të ketë në kompetencë këtë çështje, do të ketë shpjegime të detajuara në vijim.

Shumica e cilësuar, 3/5 apo 2/3 në votimin e Kuvendit ka qenë gjithashtu pjesë e debateve në komision. Qëndrimet e opozitës kanë qenë jo koherente. Megjithatë, bazuar në kërkesën e saj që në fillimet e zbatimit të reformës, Kuvendi të vendoste me shumicë të cilësuar 2/3, kjo kërkesë

është mbajtur parasysh në projektligjin e ndryshimeve kushtetuese. Për këtë çështje e cila nuk pati dakordësi dhe që sipas Komisionit të Venecias ishte çështje për vendimmarrje politike, u dakortësua që të lihet e hapur për një diskutim të mëvonshëm.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, në mbledhjen e datës 19 korrik 2016, në përmbyllje të procesit të punës për përgatitjen e seancës plenare bëri disa ndryshime në projektin kushtetues të miratuar më datën 14 qershor 2016 duke hequr disa prej amendamenteve dhe duke ndryshuar disa amendamente të tjera. Këto ndryshime u diktuan nga nevoja për të reflektuar ndaj reagimeve të grupeve politike parlamentare lidhur me faktin se një pjesë e këtyre amendamenteve kalonin përtej mandatit të caktuar nga Kuvendi. Gjithashtu në këto ndryshime reflektohet edhe propozimi hibrid i prezantuar në emër të SHBA dhe BE, si zgjidhje kompromisi ndërmjet palëve politike.

Gjithashtu, në vijim të gjetjes së kompromisit ndërmjet palëve politike, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, në mbledhjen e datës 21 korrik 2016 bëri amendime lidhur me formulën e zgjedhjes nga Kuvendi të anëtarëve jogjyqtarë dhe joprokurorë respektivisht për KLGJ dhe KLP.

D. RISITE DHE SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN E POSAÇËM

Projektligji i hartuar dhe i depozituar në Komisionin e Posaçëm të Reformës në Drejtësi përbëhet prej dispozitave të cilat ndryshojnë dispozitat në fuqi, ose janë dispozita të reja ose paragrafë të rinj në dispozitat ekzistuese. Projekti i ndryshimeve kushtetuese është i shoqëruar me një aneks të emërtuar “Rivlerësim kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Në parim, shtesat dhe ndryshimet e depozituara në nismën e deputetëve rregullonin: *së pari*, disa detyrime pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian; *së dyti*, reformimin e përhershëm të sistemit të drejtësisë dhe *së treti*, dispozita kalimtare në lidhje me masat e posaçme që synojnë rivlerësimin e përshtatshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

- **DISPOZITA QË PARASHIKOJNË DETYRIME PAS ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË BE**

Bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias për përfshirjen e disa dispozitave lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në BE dhe pasojat juridike të këtij procesi, komisioni mori parasysh rekomandimin duke saktësuar se këto dispozita do të hyjnë në fuqi pas anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ky model u zgjodh me qëllim që të mos ndërhyhet sërish në një moment të dytë në Kushtetutë, por edhe për faktin se në disa aspekte, e drejta e BE-së ka

filluar ose mund të fillojë në të ardhmen të japë efekte juridike në rendin ligjor shqiptar edhe pa u realizuar anëtarësimi i plotë i Shqipërisë në BE.

Në diskutimin e zhvilluar në Komisionin e Posaçëm Parlamentar ka pasur edhe një qëndrim për mospërfshirjen e tyre në këtë fazë. Një pjesë e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë shprehën rezervat e tyre, duke i konsideruar ato të parakohshme, pasi koha e anëtarësimit është ende jo aq e afërt sa t'i paraprihet në këtë moment me parashikimin e tyre. Një pjesë e anëtarëve në Komisionin e Posaçëm Parlamentar shprehën mendimin se miratimi i këtyre dispozitave është i natyrshëm dhe ato mund të miratohen në këtë fazë. Një pjesë e tyre do të zbatohen kur Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, ndërkohë që disa prej tyre “*de facto*” kanë gjetur zbatim në praktikë si: raportimi në Kuvend lidhur me aktet që hartohen në kuadër të pjesëmarrjes në Shqipërisë në institucionit e Bashkimit Europian.

Është me rëndësi të theksohet se në përgjigje të pyetjeve të anëtarëve të komisionit gjatë diskutimeve të kryera, përfaqësuesi i Misionit EURALIUS në Komisionin e Posaçëm Parlamentar shprehu mendimin se këto dispozita duhet të përfshihen në projektligj duke argumentuar se Shqipëria si vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në pritje të hapjes së negociatave ka marrë një sërë angazhimesh në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar dhe se dispozita të tilla dëshmojnë qartë angazhimin e Shqipërisë në rrugën europiane.

Nga varianti i rishikuar i projektit ndryshimeve kushtetuese të depozituar më datë 17 Qershor 2016 nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, projekt i cili ka mbështetjen e më shumë se 1/5 të deputetëve të Kuvendit janë hequr dispozitat që përcaktonin detyrimet e Shqipërisë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian (me përjashtim të dispozitave që ndryshojnë nenet 43 dhe 73 të Kushtetutës). Anëtarët e Komisionit shprehën mirëkuptimin për të rikonsideruar këtë çështje. Natyrisht, që puna e çmuar që është bërë për hartimin e këtyre dispozitave nuk do të humbasë. Ajo do të përdoret në reformat e ardhshme kushtetuese. Çdo ndryshim i nevojshëm i Kushtetutës si pasojë e anëtarësimit të Shqipërisë në BE do të ndërmerret në momentin më të parë të mundshëm nga parlamenti shqiptar në të ardhmen.

Në përfundim nenet 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 10, 11, 12 dhe 56 të pjesës së parë të projektit të ndryshimeve kushtetuese të depozituar hiqen.

MBI EFIÇENCËN DHE PAVARËSINË E GJYKATËS KUSHTETUESE

Vlerësimi i dispozitave dhe praktikës kushtetuese lidhur me emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (GJK) tregoi se procesi i emërimit/zgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë kushtetues nuk ka rezultuar efikas. Ky vlerësim ka identifikuar:

- mungesa e kriterëve të qarta për kandidatët;
- mungesa e transparencës në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe në propozimin e tyre Kuvendit;
- mungesa e transparencës në dhënien e (mos)pëlqimit nga Kuvendi. Si rrjedhojë, gjyqtarët rregullisht qëndrojnë në detyrë tej mandatit për shkak të mosplotësimit në kohë të vendeve vakante;
- mungesa e dispozitave të qarta kushtetuese lidhur me përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarët kushtetues si dhe
- mungesa e dallimit midis shkaqeve të mbarimit të mandatit dhe shkarkimit, gjë që ka krijuar paqartësi për pasojat e secilës prej tyre.

Gjithashtu, formulimi i dispozitave që rregullojnë juridiksionin e GJK dhe rrethin e subjekteve që e vënë atë në lëvizje, ka bërë që në disa raste ankimi në GJK të mos jetë një mjet tërësisht efektiv për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, siç theksohet në disa vendime të GJEDNJ. Këto mangësi të vërejtura kanë çuar edhe në mungesën e cilësisë dhe efikasitetit në vendimmarrjen e GJK.

Përkundrejt këtyre problemeve të evidentuara nga Dokumentin Analitik të Sistemit të Drejtësisë, si dhe në përmbushje të objektivave të Reformës në Gjykatën Kushtetuese të artikuluar në dokumentin e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar ka bërë një sërë përmirësimesh që trajtohen në vijim.

1. Anëtarët e GJK do të emërohen sipas kësaj formule: 3 anëtarë nga Presidenti, 3 nga Kuvendi dhe 3 nga mbledhja e GJL

Formula e propozuar mundëson përfaqësimin e disa degëve të pushtetit. Për anëtarët që do të miratohen nga Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë propozohet të gjejë zbatim procesi i përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve më të kualifikuar bazuar në një proces transparent të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Ky Këshill do të bëjë renditjen e kandidaturave, sipas kriterëve të parashikuara në ligjin organik.

Gjithashtu, propozohet që Kuvendi t'i zgjedhë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicë prej 3/5 të të gjithë anëtarëve. Kjo formulë zgjedhjeje siguron pjesëmarrjen e disa organeve dhe grupeve të interesit në proces, pasi secili organ ka kompetencë thelbësore dhe të pandarë me të tjerët, gjë e cila garanton mosbllokimin e procesit, duke krijuar edhe mundësinë e kombinimit të përvojave të anëtarëve të kësaj gjykate. Kjo formulë mundëson që ky proces të mos dominohet nga interesat e politikës, si dhe mundëson balancimin midis pushteteve.

2. Përcaktimi i kritereve për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese

Kriteret bazë objektive të përzgjedhjes përcaktohen kryesisht në Kushtetutë, por do të parashikohen edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese. Ato fokusohen më së shumti te merita profesionale dhe etike e kandidatit. Parashikimi i kritereve të domosdoshme për t'u pasur nga kandidatët do të jenë kryesisht: përvoja të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike.

Kandidatët duhet të jenë me integritet të lartë moral dhe profesional dhe të mos kenë qenë anëtarë të forumeve drejtuese të partive politike. I gjithë procesi i emërimit do të karakterizohet nga transparenca dhe publiciteti (që kanë munguar deri sot), pasi këto elemente kontribuojnë në cilësinë e drejtësisë kushtetuese dhe po ashtu në perceptimin dhe forcimin e besimit të publikut mbi pavarësinë e gjyqtarëve kushtetues dhe për rrjedhojë në legjitimitetin e garantit të Kushtetutës.

3. Zgjedhja e Kryetarit të GJK

Kryetari i GJK do të bëhet nga vetë anëtarët e GJK. Kjo zgjidhje garanton pavarësi të mëtijshme të Kryetarit nga organet e emërimit dhe rrit shkallën e përgjegjshmërisë së anëtarëve të GJK për të rregulluar vetë punët e tyre të brendshme. Procedurat e zgjedhjes së Kryetarit do të parashikohen drejtpërdrejtë në ligjin organik të GJK.

4. Dorëheqja dhe mbarimi i mandatit të Gjyqtarit të GJK

Projektligji i ndryshimeve kushtetuese parashikon procedura të sakta për dhënien dhe pranimin e dorëheqjes së gjyqtarit të GJK, të cilat mungojnë në ligjin aktual. Ai parashikon që gjyqtari ia paraqet dorëheqjen me shkrim Kryetarit të Gjykatës, i cili njofton organin përkatës të emërtesës me qëllim marrjen e masave për caktimin e gjyqtarit pasardhës brenda një afati të caktuar ligjor nga paraqitja e kërkesës për dorëheqje. Gjithashtu, propozohet një rregullim i qartë në Kushtetutë i rasteve të mbarimit të mandatit të GJK për raste të tilla si: përfundimi i afatit të qëndrimit në detyrë ose arritja e një moshe maksimale; dorëheqja ose shkarkimi.

5. Procedimi disiplinor

Propozohet një sistem i mirëfilltë disiplinor që përfshin gjyqtarët e GJK edhe rastet e shkarkimit të tyre. Procedimi disiplinor i tyre i lihet vetë GJK-së, sipas një procedure të detajuar të parashikuar në ligjin organik të GJK.

6. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese

Juridiksioni i GJK zgjerohet në funksion të mbrojtjes më efikase të të drejtave të individit. Sugjerohet që të bëhen disa ndryshime me prirje të zgjerimit të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me: (a) shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit që rishikon Kushtetutën, kur nuk është respektuar procedura e miratimit të këtij ligji; (b) zgjerimin e ankimit kushtetues individual, i cili duhet të riformulohet me qëllim një mbrojtje më të madhe të individit ndaj akteve të pushtetit publik (*modeli gjerman-Verfassungsbeschëerde*), siç është vlerësuar edhe nga opinioni i Komisionit të Venecias; (c) shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të KLGJ dhe KLP pas një procedure disiplinore sipas Kushtetutës (shih më sipër) si dhe rastet e shkarkimit për anëtarët e këtyre Këshillave, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, saktësohet rrethi i subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues, duke shtuar subjektet që kanë si thelb të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

NEVOJA PËR PAVARËSINË DHE EFEKTIVITETIN E GJYKATËS SË LARTË (GJL)

Bazuar në rekomandimet dhëna në opinionin e Komisionit të Venecias, Komisioni i Posaçëm Parlamentar propozoi si më poshtë:

- Heqjen e juridiksionit fillestar për gjykimin e akuzave penale kundër funksionarëve më të lartë të shtetit dhe kalimin e tij në gjykatën e posaçme të shkallës së parë dhe të apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë;
- Kthimin e Gjykatës së Lartë në një gjykatë ligji, duke e përcaktuar saktë juridiksionin e saj si një gjykatë që shqyrton në shkallë të fundit, kryesisht, ankimet për çështje të interpretimit të ligjit (jo çështje të faktit), me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore;
- Parashikimin më të detajuar të kriterëve kushtetuese për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Propozohet që ata të emërohen nga Presidenti pas përzgjedhjes që bën Këshilli i Lartë Gjyqësor. Presidenti ka të drejtë të kthejë vetëm një herë kandidatin e propozuar nga KLGJ, nëse nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit Presidenti, në rast të refuzimit të kandidatëve, duhet të arsyetojë vendimin e tij. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit e humbet efektin kur shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor votojnë kundër dekretit. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati konsiderohet i emëruar.
- Propozohet që një pjesë e trupës gjyqësore të GJL (jo më shumë se 1/5) të vijë nga radhët juristëve të spikatur si profesorë ose lektorë të së drejtës, të avokatisë dhe profesioneve të tjera ligjore, me qëllimin për të mundësuar kombinimin e përvojave profesionale në GJL. Përfaqësimi i secilit prej grupeve të sipërpërmendura të profesionistëve të ligjit në GJL duhet

të bëhet në bazë të një përqindjeje të parashikuar në ligj. Po në ligj duhet të parashikohen edhe kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për anëtar i GJL (qoftë një kandidat nga gjyqësori, qoftë një kandidat që nuk vjen nga gjyqësori). Komisioni i Posaçëm parlamentar gjykon se ky model i përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të GJL minimizon politizimin e procesit të emërimit të anëtarëve të GJL, duke nxjerrë jashtë këtij procesi parlamentin dhe duke kufizuar diskrecionin e Presidentit. Nga ana tjetër, ky i fundit vazhdon të luajë rolin e kontrollit nga jashtë sistemit gjyqësor, duke siguruar një balancë në emërimin e anëtarëve të GJL.

- Janë parashikuar kritere të qarta dhe objektive, të fokusuara tek meritat profesionale që duhen plotësuar nga kandidatët për anëtarë të GJL. Si të tilla propozohen të jenë: a) përvoja si jurist dhe përvoja profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, pedagog në universitete, jurist në pozicione të larta në administratën publike (të paktën 15 vjet); (b) Pasja e titujve shkencorë; c) integriteti i lartë moral dhe profesional (ndonëse ky kriter nuk është objektiv); ç) gjendja gjyqësore e pastër; d) të mos kenë masa disiplinore ende në fuqi; dh) të mos kenë qenë anëtarë të forumeve drejtuese të partive politike etj.
- Kryetari i Gjykatës së Lartë, ndryshe nga praktika e deritanishme që emërohet me propozim të Presidentit dhe pëlqimin e parlamentit, sipas projektligjit do të zgjidhet nga veta trupa e gjyqtarëve.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, PËRBËRJA, VENDIMARRJA DHE TRANSPARENCA

Nisur nga fenomenet negative dhe problemet e identifikuar në Dokumenti Analitik për KLD si dhe opinioni i KV, propozohet një reformatim i Këshillit si më poshtë:

- Propozohet që emërtimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë të ndryshojë në “Këshilli i Lartë Gjyqësor” ose “KLGJ” duke reflektuar natyrën të këtij organi si institucion i qeverisjes vetëm të gjyqësorit;
- Propozohet që numri i anëtarëve të jetë 11, nga të cilët 6 do të jenë gjyqtarë në mënyrë që të garantohet pavarësia dhe vetëqeverisja e gjyqësorit. Propozohet që anëtarët gjyqtarë të emërohen nga kolegët e tyre të të gjitha niveleve, duke siguruar përfaqësim të drejtë nga të gjitha gjykatat. Kjo mënyrë e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë respekton parimin e proporcionalitetit, sepse përfshin të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe krijon një raport të drejtë midis anëtarëve gjyqtarë dhe jo-gjyqtarë.
- Përmbajtja e nenit 34 të projektligjit që ndryshon nenin 147 të Kushtetutës, fillimisht parashikonte që anëtarët jogjyqtarë për në Këshillin e Lartë Gjyqësor zgjidhen mbi bazën e propozimeve nga radhët e avokatëve (një anëtar), nga radhët e noterëve (një anëtar), nga

trupa e pedagogëve të drejtësisë (një anëtar), nga trupa e pedagogëve jo gjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës (një anëtar) dhe nga shoqëria civile (një anëtar).

Neni 34 i projektligjit (pas ndryshimeve neni 23) që ndryshon nenin 147 të Kushtetutës është rishikuar për të reflektuar diskutimet e mëvonshme lidhur me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor të zgjedhur nga Kuvendi. Rezultati i këtyre negociatave (i kthyer në gjuhë normative) është se mënyra më e përshtatshme për të garantuar pjesëmarrjen e opozitës parlamentare në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit është krijimi i një nënkomisioni parlamentar, nga anëtarët e komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore, me 3 anëtarë nga shumica parlamentare dhe dy nga opozita, i cili për zgjedh kandidatët të cilët miratohen nga Kuvendi.

- Konkretisht, propozohet që 5 anëtarët jo gjyqtarë të KLGJ të zgjidhen nga Kuvendi, mbi bazën e propozimeve të ardhura nga radhët e avokatëve, dy anëtarë; nga trupa e pedagogëve dhe shkollës së magjistraturës dy anëtarë; dhe nga shoqëria civile një anëtar. Procedura e emërimit do të jetë si vijon:

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

Me paraqitjen e kandidaturave, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji. Pas përfundimit të verifikimeve, lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale i dërgohet menjëherë nënkomisionit parlamentar. Kandidatët e përzgjedhur nga nënkomisioni, në një listë të vetme i paraqiten Kuvendit për votim. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës, Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur.

- Propozohet që anëtarët e KLGJ t'i kryejnë funksionet e tyre me kohë të plotë, me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe respektimit të kolegjalitetit të këtij organi, për të shmangur konfliktet e mundshme të interesit, si dhe për të garantuar përgjegjshmërinë e anëtarëve në ushtrimin e funksioneve të tyre. Kjo nënkupton që mandati i anëtarëve gjyqtarë pezullohet gjatë kohës së shërbimit në KLGJ dhe llogaritet për efekt të vjetërsisë në punë. Në përfundim të afatit të shërbimit në KLGJ, anëtari gjyqtar duhet kthehet në pozicionin e mëparshëm. Ndërsa anëtarit që vjen nga GJL dhe gjykatat e posaçme i ndërpritet mandati gjatë kohës që shërben si anëtar i KLGJ. Anëtari jo gjyqtar, i cili përpara emërimit në KLGJ punonte me kohë të plotë në sektorin publik, në përfundim të afatit të shërbimit në KLGJ kthehet gjithashtu në pozicionin e mëparshëm.
- Propozohet që Presidenti i Republikës të mos jetë anëtar i KLGJ me qëllim shmangien e influencave politike në KLGJ. Propozohet që Ministri i Drejtësisë të marrë pjesë në mbledhjet e KLGJ kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor. Fillimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve i kalon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Propozohet që Kryetari i KLGJ zgjidhet nga vetë Këshilli, nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë.
- KLGJ është përgjegjëse për emërimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, vlerësimin, transferimin dhe promovimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit; disiplinën e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, duke përfshirë shqyrtimin e ankesave dhe inspektimin e veprimtarisë së gjyqtarëve. Propozohet që KLGJ të ketë të njëjtat kompetenca edhe mbi anëtarët e GJL. Ndryshimi do të ketë në lidhje me emërimin e anëtarëve të GJL për të cilët KLGJ do të ketë kompetencë për propozimin e kandidatëve (*shih më lart*). Një zgjidhje e tillë rrit pavarësinë dhe përgjegjësinë e KLGJ për të gjitha çështjet që lidhen me statusin e gjyqtarëve, ç'ka është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me opinionin e Komisionit të Venecias.
- Propozohet që KLGJ-së të ketë përgjegjësi për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, mbajtjen e sistemit statistikor të gjyqësorit, marrëdhëniet e gjyqësorit me publikun dhe mediat, menaxhimin e administratës gjyqësore, raportimin para publikut dhe Kuvendit, administrimin e infrastrukturës fizike dhe të sigurisë, si dhe matjen e performancës së gjykatave.
- KLGJ do të jetë institucioni përgjegjës për buxhetin gjyqësor. Ministri i Drejtësisë përfshihet në këtë proces duke marrë pjesë në mbledhjet përkatëse të KLGJ. Kjo zgjidhje shmang përfshirjen e drejtpërdrejtë të ekzekutivit në kontrollin e çdo detaji të buxhetit operacional të gjykatave, garanton pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare, si dhe lejon një qasje më gjithëpërfshirëse në zhvillimin e politikave të sektorit buxhetor. Për këtë arsye propozohet që edhe përgjegjësitë për planifikimin strategjik të ushtrohen nga KLGJ duke përfshirë në këtë proces Ministrin e Drejtësisë. Kjo kompetencë është parashikuar nga neni 147/a i projektligjit. Ky ndryshim dikton nevojën që neni 144 i Kushtetutës së RSH të shfuqizohet.
- Propozohet që KLGJ të mos ketë kompetencën për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe të ankesave kundër gjyqtarëve dhe për inspektimin e gjykatave. Për këtë qëllim propozohet të krijohet një organ i ri, Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të jetë një organ i pavarur përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, të anëtarëve të KLGJ, të prokurorëve të të gjitha niveleve, të anëtarëve të KLP dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Inspektori do të jetë gjithashtu përgjegjës për fillimin e procedimit disiplinor kundër zyrtarëve të sipërpërmendur dhe për inspektimin e gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Projektligji për ndryshime kushtetuese për këtë çështje përmban ndryshimet e mëposhtme:

- Procedimet disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj gjyqtarëve do të shqyrtohen dhe vendosen nga KLGJ. Procedimet disiplinore të filluara nga Inspektori ndaj prokurorëve do të shqyrtohen dhe vendosen nga KLP. Ndërsa procedimet disiplinore ndaj anëtarëve të këtyre dy këshillave (KLGJ dhe KLP) si dhe ndaj Prokurorit të Përgjithshëm do të shqyrtohen dhe vendosen nga Gjykata Kushtetuese;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, midis kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita;
- Inspektori do të ketë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe një mandat nëntë vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- Kryerja e inspektimit nga një organ i pavarur, siç është Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i nevojshëm, sepse e shkëput inspektimin nga procesi vendimmarrës për dhënien e masës disiplinore. Ndërsa emërimi i Inspektorit nga Kuvendi me tri të pestat e të gjithë anëtarëve mbi listën e kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi, do të ndihmojë për depolitizimin e procesit të emërimit dhe garantimin e cilësisë profesionale dhe integritetit të Inspektorit.
- Në projektligj rregullohet përgjegjësia disiplinore. Hetimi për mbledhjen e provave dhe fakteve që vërtetojnë shkeljet e rënda të Inspektorit, do të kryhet nga një komision hetimor parlamentar. Kjo zgjidhje shkon në linjë të praktikës parlamentare. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese do të vendosë për shkarkimin ose jo nga detyra të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi do të jetë përgjegjës për të verifikuar përmbushjen e kushteve ligjore dhe të kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Propozohet që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të shqyrtojë dhe të rendisë sipas meritës kandidatët e propozuar nga institucionet propozuese. Ky rregullim do të ndikojë në depolitizimin e procesit të emërimeve në pozicionet e larta në drejtësi, duke ulur diskrecionin e organeve politike të emërtesës dhe do të rrisë cilësinë në përbërjen e institucioneve që drejtojnë sistemin e drejtësisë.

Përbërja e këtij Këshilli do të jetë nga gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ndryshme të zgjedhur me short, me qëllim shmangien e koorporatizimit dhe ndikimit të papërshtatshëm në emërimin e këtyre funksionarëve. Sikurse është analizuar edhe më lart, ky rregullim ndryshon nga varianti i parë i depozituar në Komisionin e Posaçëm Parlamentar, mbi projektin e paraqitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, bazuar në kërkesën e anëtarëve të opozitë, diskutimeve të anëtarëve të komisionit dhe kontributin e ekspertëve të huaj.

MISIONI DHE ROLI I PROKURORISË

Prokuroria sipas Kushtetutës aktuale është vendosur në kufirin mes pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor. Si i tillë ai shfaqet si me kompetenca tipike ekzekutive, ashtu edhe me kompetenca tipike gjyqësore. Kjo ka ndikuar edhe në varësinë e dyfishtë funksionale të prokurorisë nga gjykata dhe nga ekzekutivi. Ky model është bërë shkas për pozicionin e paqartë të prokurorisë në kuadër të ndarjes dhe balancimit të pushteteve i cili ka shkaktuar mbivendosje të kompetencave të kontrollit mbi prokurorinë dhe mungesë të efektivitetit të tij (kontrollit).

Për të adresuar këtë situatë, problemet dhe mangësitë që janë shfaqur në punën e prokurorisë në vitet që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës (*shih më lart*), Komisioni ad hoc ka përpunuar disa propozime të rëndësishme për reformimin e sistemit si më poshtë:

- Parashikohet statusi i prokurorisë, si organ i pavarur i ndjekjes penale i cili do të përfshijë si pavarësinë e funksionale ashtu edhe atë organizative.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) rikonceptohet si një organ i pavarur kushtetues me kompetenca të plota për statusin e prokurorëve (rekrutimi, emërimi, transferimi, riemërimi dhe procedimi disiplinor i prokurorëve). KLP do të ketë të drejtën t'i propozojë Kuvendit kandidatin për Prokuror të Përgjithshëm.
- Ndarja e pushtetit të Prokurorit të Përgjithshëm me KLP do të ndikojë në rritjen e pavarësisë së brendshme të prokurorëve në raport me prokurorët më të lartë dhe të pavarësisë së jashtme të institucionit.
- Krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shoqërohet me kompetencën e hetimit të shkeljeve disiplinore dhe ankesave kundër prokurorëve të të gjitha niveleve, të fillimit të procedimit disiplinor ndaj tyre dhe të inspektimit të zyrave të prokurorisë (*shih më lart*).
- Parashikohet një decentralizim i pjesshëm funksional brenda sistemit të prokurorisë me qëllim që të garantohet pavarësia e brendshme e prokurorëve kundrejt prokurorëve më të lartë në hetimin e çështjeve konkrete dhe ngritjen e akuzës publike. Decentralizimi i pjesshëm funksional i prokurorisë nuk e vë në rrezik funksionimin e organit, sepse do të

shoqërohet me ndryshimet e nevojshme në legjislacionin procedural penal që do t'i japin rol gjykatës në zhvillimin e hetimit penal. Gjykata do të kryejë kontrollin funksional të prokurorëve që deri tani kryhej nga prokurorët më të lart. Prokurorët më të lartë do të ruajnë disa kompetenca të mbikëqyrjes funksionale mbi prokurorët më të ulët.

- Parashikohen kriteret bazë që duhet të përmbushë kandidati për Prokuror të Përgjithshëm për të garantuar cilësinë e kandidatëve dhe integritetin e tyre, sipas një procedure transparente dhe publike për përzgjedhjen e tyre në funksion të forcimit të besimit të publikut për integritetin dhe profesionalizmin e kandidaturës.
- Propozohet që emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm të bëhet nga 3/5 e deputetëve, me propozim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për një periudhë 7 vjeçare, pa të drejtë riemërimi. Procedura për përzgjedhjen dhe emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm do të përcaktohet me ligj. Për të garantuar më tej pavarësinë e Prokurorit të Përgjithshëm propozohet që pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë, ai të emërohet në detyrën që kishte para emërimit ose gjyqtar në gjykatën e apelit.
- Për hetimin e çështjeve që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe të akuzave penale kundër funksionarëve më të lartë të shtetit, propozohet të krijohet një gjykatë e posaçme e shkallës së parë dhe e apelit, si dhe prokuroria e posaçme pranë këtyre gjykatave dhe njësia e posaçme e hetimit që do të shërbejë për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe akuzave kundër zyrtarëve të lartë. Këto struktura do të jenë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni i 50 i projektligjit të depozituar në komision (pas ndryshimeve neni 39), që ndryshon nenin 149 të Kushtetutës është rishikuar për të reflektuar diskutimet e mëvonshme lidhur me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të zgjedhur nga Kuvendi. Rezultati i këtyre negociatave/diskutimeve (i kthyer në gjuhë normative) është se mënyra më e përshtatshme për të garantuar pjesëmarrjen e opozitës parlamentare në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit është si vijon:

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

Me paraqitjen e kandidaturave, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji. Pas përfundimit të verifikimeve, lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale i dërgohet menjëherë nënkomisionit për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Nënkomisioni i cili përbëhet nga 5 deputetë anëtarë të komisionit të përhershëm për çështjet ligjore, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare, përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

Përmbajtja e nenit 50 të projektligjit që ka lidhje me nenin 149 të projektit të ndryshimeve kushtetuese fillimisht parashikonte që anëtarët jogjyqtarë për në Këshillin e Lartë Prokurorisë zgjidhen mbi bazën e propozimeve nga radhët e avokatëve (një anëtar), nga radhët e noterëve (një anëtar), nga trupa e pedagogëve të drejtësisë (një anëtar), nga trupa e pedagogëve jo gjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës (një anëtar) dhe nga shoqëria civile (një anëtar).

Në variantin e rishikuar (neni 39) propozohet që 5 anëtarët jo gjyqtarë të KLP të zgjidhen nga Kuvendi, mbi bazën e propozimeve të ardhura nga radhët e avokatëve, dy anëtarë; nga trupa e pedagogëve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, dy anëtarë; dhe nga shoqëria civile një anëtar. Procedura e ndjekur nga Kuvendi është si në rastin e anëtarëve të KLGJ.

IMUNITETI I GJYQTARËVE

Nga analiza e kryer në kuadrin e Reformës në Sistemin e Drejtësisë ka rezultuar se pavarësisht ndryshimit të Kushtetutës në vitin 2012, me anë të të cilit u hoq imuniteti i gjyqtarëve nga ndjekja penale (hetimi paraprak), mbrojtja e posaçme që iu rezervohet gjyqtarëve është ende e madhe. Mbrojtja nga kontrolli personal dhe i banesës në veçanti përbën një pengesë të pajustificuar në procesin e mbledhjes së provave. Numri i hetimeve dhe dënimeve penale kundër gjyqtarëve mbetet tepër i ulët pavarësisht nga kufizimi i imunitetit i kryer në vitin 2012. Për më tepër, Kodi i Procedurës Penale bën një rregullim kontradiktor të procedurave që ndiqen për arrestimin ose ndalimin e një gjyqtari, apo për të ushtruar kontroll personal mbi të ose banesën e tij. Si rezultat i këtij rregullimi kontradiktor, autorizimi i KLD për të arrestuar ose kontrolluar një gjyqtar është i nevojshëm edhe kur gjykata e ka autorizuar tashmë një veprim të tillë. Duket se formulimi aktual i nenit 126 të Kushtetutës krijon një situatë konflikti interesi në rastet kur GJK-së i duhet të japë pëlqimin për arrestimin, kontrollin personal dhe kontrollin e banesës të një anëtari të saj. Për rrjedhojë, propozohet që të bëhen ndryshimet e nevojshme kushtetuese për heqjen e plotë të imunitetit penal të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, duke lënë të paprekur imunitetin funksional të tyre.

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E GJYQTARËVE/PROKURORËVE

Dokumenti Analitik i Sistemit të Drejtësisë vlerëson se kuadri kushtetues dhe ligjor në Shqipëri nuk bën një rregullim të plotë dhe koherent të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sistemi disiplinor aktual për gjyqtarët e zakonshëm ka probleme serioze në aspektin e inspektimeve. Në këtë kuadër ka paqartësi në lidhje me natyrën e llojeve të ndryshme të inspektimit dhe verifikimit të ankesave, qëllimeve që ata ndjekin, përdorimin e gjetjeve të tyre etj. Aktualisht, përgjegjësia për kryerjen e inspektimeve mbi gjykatat dhe gjyqtarët është plotësisht e mbivendosur midis KLD dhe MD. Një tjetër problem që prek regjimin disiplinor të

gjqtarëve të zakonshëm është fakti se MD ka të drejtën ekskluzive për fillimin e procedimit disiplinor kundër gjyqtarëve. Nga ana tjetër, inspektimi i prokurorëve është kompetencë e MD. Ky rregullim është provuar që është jo funksional në praktikë. Ndërsa për anëtarët e GJK dhe të GJL nuk ekziston një sistem i mirëfilltë disiplinor dhe llogaridhënie. Kjo është e vërtetë edhe për anëtarët e KLD. Ata mund të shkarkohen nga Kuvendi, vetëm përmes një procedure *impeachment*-i.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar gjykon se Kushtetuta duhet të parashikojë:

- Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët do t'i nënshtrohen një regjimi përgjegjshmërie dhe discipline. Ligjet e veçanta do të parashikojnë shprehimisht shkeljet disiplinore konkrete, të saktësojnë procedurën e procesit disiplinor, procedurën e bashkëpunimit ndërmjet organeve disiplinore dhe organeve të tjera të tilla si ILDKP, autoritetet tatimore, të pastrimit të parave etj. Gjyqtari/prokurori që shfaq rritje të pashpjegueshme të pasurisë ose të nivelit të jetesës ka barrën e provës në procesin disiplinor, si dhe mund të shkarkohen kur nuk arrijnë të justifikojë pasurinë e deklaruar;

- Inspektori i Lartë të Drejtësisë do të ketë kompetencë të hetojë çështjet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve dhe të kërkojë fillimin e procedimit disiplinor kundër tyre. Projekti parashikon krijimin e një strukture të vetme inspektimi për të gjithë gjyqtarët, me përjashtim të gjyqtarëve të GJK, të gjithë prokurorëve, anëtarëve të KLGJ, të KLP. Ai duhet të ketë të drejtën të fillimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve para KLGJ, ndaj prokurorëve para KLP, ndaj anëtarëve të këtyre dy këshillave dhe Prokurorit të Përgjithshëm para GJK. Kjo do të mundësonte kapërcimin e konfliktit institucional të kompetencave ndërmjet MD dhe KLGJ në lidhje me procesin e inspektimit dhe të fillimit të procedimit disiplinor, do të përqendronte në një dorë kompetencën e inspektimit dhe do të bënte të mundur që të përdoren më me efektivitet burimet e kufizuara njerëzore, si dhe miratimin e një kuadri ligjor të plotë për hetimin/inspektimin, gjë që është në pajtim me standardet Evropiane.

MASAT ANTIKORRUPSION

Prokuroria shqiptare është e organizuar në mënyrë thellësisht hierarkike dhe të centralizuar, me prokurorët më të ulët që i nënshtrohen urdhrave dhe udhëzimeve të atyre më të lartë. Funksionimi i prokurorisë sipas parimit të hierarkisë, ndër vite, ka shkaktuar pasoja të dëmshme në veprimtarinë e saj, me ndikim në respektimin e ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit dhe procedimit sipas parimeve të objektivitetit dhe transparencës në vendimmarrje. Pavarësia e prokurorëve në raport me drejtuesin hierarkik është praktikisht e kufizuar duke i kthyer ata në zbatues të urdhrave të eprorëve.

Departamenti për Hetimin e Krimit Ekonomik, Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen në shkallë të parë të

çështjeve të korrupsionit që përfshijnë Presidentin, Kryeministrin, anëtarët e qeverisë, deputetët dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

Pavarësisht transferimit të kompetencave për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin që përfshin "zyrtarë të lartë" në Prokurorinë për Krime të Rënda, çështjet e korrupsionit ku përfshihen zyrtarët më të lartë të shtetit (Presidenti, Kryeministri, Ministrat, deputetët dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese) nuk hetohen nga kjo prokurori, sepse juridiksioni për veprat penale që përfshijnë këta zyrtarë sipas nenit 141 të Kushtetutës i takon Gjykatës së Lartë. Ky rregullim ka krijuar probleme për dy arsye. *Së pari*, sepse përjashtohen zyrtarët më të lartë nga zbatimi i sekuestrimit parandalues sipas ligjit antimafia. *Së dyti*, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë vendosin për çështje që përfshijnë politikanët të cilët i kanë kandiduar dhe emëruar ata.

Një pengesë tjetër, deri tani, ka qenë edhe mbrojtja e veçantë nga imuniteti që gëzojnë këta zyrtarë sipas kushtetutës aktuale. Për këto arsye, propozohet:

- Krijimi i një zyre prokurorie të posaçme të pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm, e cila do të ketë brenda saj një strukturë hetimi me kompetenca që mund të hetojë në mënyrë të pavarur krimin e organizuar, korrupsionin dhe veprat penale të funksionarëve të lartë. Për këtë qëllim, propozohen dhe ndryshime kushtetuese që të qartësohet e drejta e prokurorit të një niveli më të ulët për vijuar ndjekjen penale nëse çështja pushohet nga prokurori më i lartë.
- Ngritja e një zyre prokurorie të posaçme që do të sjellë më tepër efikasitet në luftën kundër korrupsionit. Kjo njësi do të jetë përgjegjëse edhe për ndjekjen penale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të lartë, të parashikuar në ligj. Çështjet e hetuara prej kësaj strukture do të gjykohen nga gjykata e posaçme e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, sipas ligjit. Parashikimi në kushtetutë i kësaj strukture me kompetencat e veta dhe të pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm do të bëjë të mundur sigurimin e mirëfunksionimit të saj pa hasur në pengesa që mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të legjislacionit. Ky parashikim në Kushtetutë dëshmon edhe përparësinë për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si një nga kushtet kryesore për pranimin e Shqipërisë në BE.
- Prokurorët e prokurorisë së posaçme do të emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ligji do të parashikojë kriteret e posaçme për prokurorët e kësaj prokurorie të tilla si: (a) jo më pak se 10 vjet përvojë si prokurorë, (b) të padënuar më parë me vendim gjykate, dhe (c) integritet të lartë moral. Para emërimit në këtë detyrë ata plotësojnë deklaratën e pasurisë dhe të konfliktit të interesave, si dhe i nënshtrohen kontrolleve periodike të figurës, pasurisë, kontrollit financiar dhe të telekomunikacionit, i cili shtrihet edhe ndaj familjarëve të afërt.
- Ndonëse nuk është rregulluar shprehimisht në Kushtetutë, ligji do të parashikojë që prokurorët e kësaj strukture do të jenë të pavarur jo vetëm nga Prokurori i Përgjithshëm por edhe nga njëri-tjetri (në rastet kur ata duhet të hetojnë edhe ndaj kolegëve të tyre). Kjo është zgjidhja më e mirë organizative që mundëson realizimin e funksionit që ata kanë. Përfitime dhe garanci të tjera për shkak të detyrës do të parashikohen në ligj. Këta prokurorë, pavarësisht se nuk kanë varësi organizative, i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, sipas ligjit.

RIVLERËSIMI KALIMITAR I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE⁴

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve është një nga masat kryesore për konsiderimin profesional, për të shmangur sistemin e drejtësisë nga ndikimi i interesave politike, lidhjet korruptive dhe ndikimin e krimit të organizuar. Publiku dhe institucionet ndërkombëtare kanë shprehur një mosbesim të theksuar në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë. Ky është një moment që sistemi shqiptar i drejtësisë t'i nënshtrohet një reforme të thellë dhe të plotë. Një reformë në sistemin e drejtësisë nuk mund të arrihet pa një vlerësim të gjithanshëm të njerëzve që punojnë aktualisht në sistem.

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve i të gjitha niveleve bazohet në rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Në raportin e tij final, Komisioni i Venecias thekson se:

54. Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për të vlerësuar gjyqtarët dhe prokurorët, Komisioni i Venecias është i mendimit që këto masa jo vetëm që janë të justifikuara, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor.

55. Projekt ndryshimet e rishikuara marrin parasysh kritikën që ka bërë Komisioni në Opinionin e Ndërmjetëm. Varianti i ri i Aneksit është shkruar në mënyrë më të saktë dhe shumica e sugjerimeve të Komisionit të Venecias janë marrë parasysh. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi.

Krahasuar me versionin e diskutuar më 14 qershor 2016, në nenin B të Aneksit janë bërë disa saktësime dhe ndryshime redaksionale, ndërsa në nenin C të Aneksit janë reflektuar ndryshimet e artikuluara në propozimin e Znj. Victoria Nuland, ndihmës-sekretare të Departamentit Amerikan të Shtetit. Këto ndryshime:

- Njohin një rol të rëndësishëm të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në procesin e verifikimit të integritetit dhe aftësive profesionale të anëtarëve të organeve të rivlerësimit, duke i dhënë rekomandime Kuvendit për kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për organet që do merren me rivlerësimin, paraqet gjetje dhe mendime, etj
- Mbajnë parasysh rekomandimin e paragrafit 88 të Komisionit të Venecias dhe të pasqyrojnë dakordësinë e partnerëve të SHBA-së dhe BE-së;
- Njohin rolin substancial të opozitës në procesin e propozimit të organeve të rivlerësimit;

⁴ Procesi i rivlerësimit është parashikuar si aneks në projektligj.

- Respektojnë parimin e sovranitetit të Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjen e organeve të rivlerësimit dhe në vendimmarrjen e tyre.

Masat që propozohet të merren me qëllim ndryshimin e situatës në sistemin e drejtësisë është :

- Ngritja e një sistemi rivlerësimi tërësor të gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim uljen e ndikimit të krimit të organizuar, politikës dhe elementëve të tjerë korruptivë në dhënien e drejtësisë por edhe rritjen e cilësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Janë parashikuar mekanizma konkrete më të cilët synohet që rivlerësimi të bazohet mbi një sistem rregullash të forta të deklarimit të pasurisë, duke përfshirë krijimin e një gjykate dhe zyre të prokurorisë antikorrupsion si dhe të një shërbimi hetimor për këtë qëllim.
- Procesi i rivlerësimit do të përfshijë kontrollin tërësor të gjyqtarëve dhe prokurorëve në tre elementë të rëndësishëm: pasuritë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, zbulimin ose identifikimin e lidhjeve të tyre me krimin e organizuar dhe së fundmi vlerësimin e punës së bërë dhe aftësitë e tyre profesionale. Nëse rezultati përfundimtar i këtyre tri vlerësimeve rezulton negativ ose i pamjaftueshëm, Komisioni do të dalë me një vendim që varion nga detyrimi i gjyqtarit ose prokurorit për riaftësim pranë Shkollës së Magjistraturës për një vit – në rast se aftësitë profesionale nuk janë të mjaftueshme - deri në largimin nga detyra. Ekzaminimi i trefishtë i gjyqtarëve dhe prokurorëve ka për qëllim jo vetëm shkëputjen individëve të lidhur me krimin, por edhe të atyre të paafte që i kanë përfituar vendet e punës mbi bazën e lidhjeve korruptive, politikisht ose financiarisht.
- Krijohet një Komision i Pavarur i Kualifikimit që do të bëjë vlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, pavarësisht nivelit dhe juridiksionit në shkallë të parë. Anëtarët e Komisionit do të jenë juristë të cilët kanë përvojë të gjatë (të paktën 15 vjet) si gjyqtarë, prokurorë, avokatë ose profesorë të së drejtës si dhe gëzojnë reputacion të lartë. Ata do të kenë statusin e anëtarit të GJL.
- Vendimet e Komisionit do të shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Kolegji i Apelimit do të përbëhet nga gjyqtarë që do të gjykojnë vetëm çështjet që lidhen me vlerësimin dhe rivlerësimin, sipas aneksit. Detajet e funksionimit të Komisionit dhe të Kolegjit do të parashikohen në ligj. Ky proces do të kryhet nga strukturat vendase në mbikëqyrjen e vëzhguesve ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e besueshmërisë ndaj procesit.
- Me qëllim garantimin e procesit, por edhe uljen e mundësisë së korrupsionit brenda komisionit, anëtarët e tij do të kenë një trajtim të posaçëm për veten dhe familjen e tyre. Atyre do t'u garantohet edhe mbrojtje e posaçme nga shteti.

Anëtarët e Komisionit propozuan ndryshime në rolin dhe funksionimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) gjatë procedurës së emërimit të anëtarëve të komisionit të posaçëm dhe kolegjit të apelimit për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Konkretisht, u propozua që Presidenti, pas pranimit të aplikimeve nga kandidatët, të hartojë një listë me kandidatë të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale, dhe ia dërgon ato ONM.

Një komision i përbërë nga 3 vëzhgues të ONM vlerëson aftësitë profesionale, integritetin moral sipas parashikimit të ligjit. Jo më vonë se katërmëdhjetë ditë nga paraqitja e listave të Presidentit, Komisioni, bazuar në vlerësimet e tij, i dërgon rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

Kuvendi krijon një komision ad hoc me gjashtë anëtarë të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare i cili brenda dhjetë ditëve nga krijimi i tij, i përcjell listën e kandidatëve për votim për secilin pozicion komisioneve ad hoc përzgjedhëse. Kuvendi krijon brenda dhjetë ditëve dy komisione ad hoc përzgjedhëse të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, ku një komision ka 12 anëtarë dhe një ka 6 anëtarë.

Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga dy komisionet ad hoc përzgjedhëse përmbledhen në një listë të vetme dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve në bllok me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk e miraton listën e kandidatëve në bllok, Kryetari i Kuvendit ia kthen atë komisioneve ad hoc për përsëritjen e procesit të përzgjedhjes dhe dërgimin e një listë të dytë brenda 10 ditësh. Kuvendi, brenda 10 ditëve, mund ta rrëzojë në bllok listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në rast se lista nuk rrëzohet, kandidatët e përzgjedhur konsiderohen të zgjedhur.

DISPOZITAT TRANZITORE

Reforma e propozuar në sistemin e drejtësisë prek shumë aspekte të organizimit dhe funksionimit të institucioneve kushtetuese ekzistuese të sektorit të drejtësisë. Këto rregullime diktojnë nevojën e parashikimit të dispozitave tranzitore.

Së pari, shtesat dhe ndryshimet kushtetuese të propozuara përfshijnë GJK, GJL, KLD, Prokurorinë dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në qeverisjen e gjyqësorit.

Së dyti, shtesat dhe ndryshime të propozuara do të krijojnë institucione të reja të qeverisjes së gjyqësorit. Të tilla janë Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Së treti, amendamentet e propozuara bëjnë një rishpërndarje të përgjegjësisë midis institucioneve të ndryshme të drejtësisë.

Kundrejt shtesave dhe ndryshimeve thelbësore që propozohen është e nevojshme të vlerësohet edhe nëse është e mundur që institucionet ekzistuese të vazhdojnë veprimtarinë e tyre thjesht

duke miratuar disa dispozita tranzitore apo duhet të riformatohen duke ndërprerë mandatin e funksionarëve ekzistues duke i hapur rrugë kështu konstituimit të institucioneve të reja. Natyrisht që në bërjen e këtij vlerësimi ka prevaluar ideja që të ruhet sa është i mundur mandati i institucioneve ekzistuese.

Në përfundim të këtij vlerësimi propozohet:

Gjykata Kushtetuese nuk pëson ndryshimeve thelbësore. Dispozita tranzitore që rregullon përtëritjen e përbërjes së GJK sipas kushteve të reja është e mjaftueshme për të bërë të mundur që GJK t'iu përgjigjet me efikasitet detyrave të reja dhe mënyrës së re të funksionimit.

Gjykata e Lartë i nënshtrohet ndryshimeve thelbësore të cilat krijojnë një gjykatë të lartë me një fizionomi dhe me një dimension krejt të ri. Megjithatë, Komisioni *ad hoc* arriti në përfundimin se roli dhe burimi i legjitimitetit të GJL nuk ka ndryshuar mjaftueshëm për të justifikuar ndërprerjen e mandatit të gjykatës ekzistuese dhe konstituimin e një gjykate të re.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë pëson një ndryshim thelbësor në përbërje, rolit dhe kompetencat të tij. Ndryshimet më të rëndësishme përfshijnë: (i) ndryshimin e numrit të anëtarëve, nga 15 në 11, por edhe të procedurës së zgjedhjes së tyre; (ii) përbërjen e organit duke ndryshuar raportin gjyqtar – jo gjyqtar dhe profilin e anëtarëve jo gjyqtarë; (iii) suprimimin e tre anëtarëve *ex officio* në këtë organ (Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë); (iv) kryesimin e organit nga njëri prej anëtarëve jo gjyqtarë, duke i hequr këtë të drejtë Presidentit të Republikës; (v) suprimimin e funksionit kushtetues të Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; (vi) zgjerimin e madh të kompetencave të cilat propozohet të përfshijnë pothuaj të gjitha aspektet e administrimit të gjyqësorit (përfshi propozimin dhe administrimin e buxhetit) dhe planifikimin strategjik; (vii) kalimin nga anëtarësia me kohë të pjesshme në anëtarësi me kohë të plotë duke mundësuar eficiencë dhe kolegjalitet të KLGJ; (viii) parashikimin e një sistemi të mirëfilltë përgjegjshmërie për anëtarët e KLGJ; (ix) mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve; (x) marrjen e përgjegjësi për raportimin publik dhe para Kuvendit për çështje të gjyqësorit dhe (xi) ndryshimin e emrit të organit (nga KLD në KLGJ).

Duke parë thellësisë dhe gjerësisë e ndryshimeve të propozuara për KLD (të cilat nga ana e tyre janë diktuar nga problemet e identifikuar nga Dokumenti Analitik i Sistemit të Drejtësisë dhe objektivat e reformës të specifikuar në Strategjinë për Reformën në Drejtësi), propozohet miratimi i disa dispozitave tranzitore, të cilat do të kenë si pasojë mbarimin e parakohshëm të mandateve të anëtarëve të KLD dhe rregullimin e situatës ligjore që do të krijohet pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara kushtetuese.

Prokuroria rikonceptohet nga pikëpamja strukturore dhe funksionale, të kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm (PP), të mënyrës së përzgjedhjes dhe të emërimit të tij, të kohëzgjatjes

së mandatit kushtetues të PP, të procedurave për shkarkimin e tij, ndryshimin e kërkesave dhe kritereve profesionale dhe që duhet të përmbushin kandidatët për PP; ngritjen në nivel kushtetues të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe strukturimin tërësor të kompetencave të tij (Këshillit) për emërimin, karrierën, ngritjen në detyrë dhe disiplinimin e prokurorëve, të ndryshme nga rregullimi aktual kushtetues dhe ligjor; ndryshimin e raporteve hierarkike brenda sistemit të prokurorisë, me krijimin e strukturës së posaçme antikorrupsion. Për të gjitha këto arsye, është e nevojshme të parashikohen dispozita kushtetuese tranzitore për të rregulluar periudhën kalimtare deri në zgjedhjen e PP të ri.

Për shkak të kohës që do të nevojitet për konstituimin e disa institucioneve kushtetuese, duke u nisur nga fakti se disa funksione janë parashikuar për të qenë *ex officio*, pjesë e disa organeve *ad hoc*, si dhe me qëllim shmangien e çdo bllokimi në funksionimin e organeve gjatë fazës tranzitore, janë parashikuar të gjitha zgjidhjet e nevojshme, që krijojnë mundësinë për të vijuar në normalitet ushtrimi i funksionit të tyre.

Në nenin 57 të projektligjit, që ndryshon nenin 179 të Kushtetutës, janë bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

- Është hequr paragrafi 9 i tij pasi ai i referohet dispozitave tashmë të hequra të Kreut të parë (për integrimin);
- Paragrafi 12 është bërë 11 për shkak të heqjes së paragrafit 9. Në këtë paragraf janë bërë disa ndryshime redaksionale (të shënuara me germa në ngjyrë blu);
- Paragrafi 14 është bërë 13 për shkak të heqjes së paragrafit 9.
- Janë reflektuar ndryshimet që janë bërë në formulat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave dhe të anëtarëve të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- Paragrafi 13 i këtij neni parashikon mënyrën e zgjedhjes për periudhën tranzitore vetëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

Komisioni vlerëson se ky projektligj për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, transparent dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare të fushës. Ai është produkt i përbashkët i ekspertizës më të mirë vendase dhe asaj ndërkombëtare dhe veçanërisht të Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Projektligji është vlerësuar nga Komisioni i Venecias i cili thekson se:

86. Komisioni i Venecias përgëzon autoritetet shqiptare dhe sidomos ekspertët e Komisionit parlamentar ad hoc për punën që ka bërë në përgatitjen e reformës kushtetuese të gjyqësorit. Gatishmëria e tyre për të marrë parasysh rekomandimet e Opinionit të Ndërmjetëm meriton vlerësim të veçantë.

87. Projekt ndryshimet kushtetuese përmbajnë propozime të qëndrueshme për strukturën e ardhshme institucionale të gjyqësorit shqiptar; teksti në tërësi është koherent dhe në përputhje me standardet evropiane. Komisioni i Venecias beson që projekt ndryshimet mund të finalizohen pa vonesë dhe t'i paraqiten për votim parlamentit.

89. Komisioni i Venecias përsërit që reforma e gjyqësorit nuk mund të ndalojë në nivel kushtetues; një paketë e plotë ligjore do të kërkohet për të rregulluar me detaje funksionimin e KLGJ, KLP, organeve vlerësuese etj.

Projekti kushtetues përbën bazamentin e një reforme të thellë e tërësore, ligjore dhe institucionale për reformimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Zgjidhjet kushtetuese, ligjore e institucionale të ofruara përmes kësaj reforme synojnë të realizojnë funksionimin eficient të sistemit, forcimin e përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, të konsolidojnë karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes vlerësimit të meritës, aftësive profesionale dhe ndershmërisë në ushtrimin e detyrës.

Miratimi i paketës kushtetuese dhe ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe zbatimi i suksesshëm i saj, hap një faqe të re në funksionimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë, për të bërë atë realisht të pavarur, të paanshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Kjo reformë është një hap i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian.

RELATORË

Pandeli MAJKO

Vasilika HYSI

KRYETAR

Fatmir XHAFAJ

PROJEKTLIGJ

Nr. ___ / ___ / 2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998,
"KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR






Në mbështetje të neneve 83, pika 1, dhe 177 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:



Neni 1

Neni 43 ndryshohet si vijon:

“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.”

Neni 2

Në nenin 73, paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.”

Neni 3

Neni 124 ndryshohet si vijon:

“Neni 124

1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.”

Neni 4

Neni 125 ndryshon si vijon:

“Neni 125

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.
2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë

shpallet i emëruar.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Krite të tjera si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

6. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuar në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët c), ç), d) dhe dh)."

Neni 5

Neni 126 ndryshohet si vijon:

"Neni 126

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim."

Neni 6

Neni 127 ndryshohet si vijon:

"Neni 127

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:

- a) mbush moshën 70 vjeç;
- b) përfundon mandatin 9 vjeçar;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;
- d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.”

Neni 7

Neni 128 ndryshohet si vijon:

“Neni 128

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.
2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij kur:
 - a) konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;
 - b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.”

Neni 8

Neni 130 ndryshohet si vijon:

“Neni 130

Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohen kundrejt pagesës, me përjashtim të atyre të mësimdhënies, akademike dhe shkencore, sipas ligjit.”

Neni 9

Në nenin 131 bëhen këto ndryshime:

Ndryshohet nënparagrafi “f”, si vijon:

“f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.”

Shtohet paragrafi 2 si vijon:

“2. Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.”

Neni 10

Neni 132 ndryshohet si vijon:

“Neni 132

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.
2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.
3. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.”

Neni 11

Neni 133, pika 2, ndryshohet si vijon:

“2. Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.”

Neni 12

Neni 134 ndryshon si vijon:

“Neni 134

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:
 - a) Presidentit të Republikës;
 - b) Kryeministrit;
 - c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;
 - ç) Avokatit të Popullit;
 - d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
 - dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
 - e) çdo komisioneritë krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;

- ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
 - f) organeve të qeverisjes vendore;
 - g) organeve të bashkësive fetare;
 - gj) partive politike;
 - h) organizatave;
 - i) individëve.
2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët d), dh), e), ë), f), g), gj), h), dhe i) të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.”

Neni 13

Neni 135 ndryshon si vijon:

“Neni 135

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qëndrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.
3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.
4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2 të këtij neni emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.”

Neni 14

Neni 136 ndryshohet si vijon:

“Neni 136

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9 vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë Gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.
4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit, parashikohen me ligj.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139 paragrafi 3, nënparagrafët c), ç), d) dhe dh).".

Neni 15

Pas nenit 136, shtohet neni 136/a si vijon:

"Neni 136/a

1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.
2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj."

Neni 16

Neni 137 ndryshohet si vijon:

"Neni 137

Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi."

Neni 17

Neni 138 ndryshohet si vijon:

“Neni 138

Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.”.

Neni 18

Neni 139 ndryshon si vijon:

“Neni 139

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron në rastet e mëposhtme:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandatin 9 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës;
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.
3. Procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj.”.

Neni 19

Neni 140 ndryshohet si vijon:

“Neni 140

1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;

- b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:
- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një veprë penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.
4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese."

Neni 20

Neni 141 ndryshohet si vijon:

"Neni 141

1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit."
2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit."

Neni 21

Neni 143 ndryshohet si vijon:

"Neni 143

"Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit."

Neni 22

Neni 144 shfuqizohet.

Neni 23

Neni 147 ndryshohet si vijon:

"Neni 147

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh nga Kuvendi, nga radhët e juristëve jo gjyqtarë.

3. Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jo gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

4. Dy anëtarë jo gjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit sipas paragrafit 7 të këtij neni.

7. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për mospërbushje të kriterëve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

8. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmbledhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

9. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo gjyqtarë, sipas ligjit.

10. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët gjyqtarë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Gjyqtarit të

Gjykatës së Lartë, ose të gjykatës së posaçme i pezullohet mandati si gjyqtar gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Anëtarët jo gjyqtarë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barazvlefshme me to.”

Neni 24

Pas nenit 147 shtohet neni 147/a, si vijon:

“Neni 147/a

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:
 - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
 - b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
 - c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;
 - ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
 - d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;
 - e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
 - ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.
2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.”

Neni 25

Pas nenit 147/a shtohet neni 147/b, si vijon:

“Neni 147/b

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron sipas rasteve të mëposhtme:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandatin 5 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c të Kushtetutës;
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.
4. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët c), ç), d) dhe dh) të paragrafit 1 të këtij neni.”.

Neni 26

Pas nenit 147/b shtohet neni 147/c, si vijon:

“Neni 147/c

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
2. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.”.

Neni 27

Pas nenit 147/c shtohet neni 147/ç, si vijon:

“Neni 147/ç

Qenia anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore, sipas ligjit.”

Neni 28

Pas nenit 147/ç shtohet neni 147/d, si vijon:

“Neni 147/d

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin

me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

6. Procedura e vendimmarrjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rregullohet me ligj. Ankimet ndaj vendimeve lidhur me masat disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.”.

Neni 29

Pas nenit 147/d shtohet neni 147/dh, si vijon:

“Neni 147/dh

1. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur:

- a) mbush moshën e pensionit;
- b) përfundon mandatin 9 vjeçar;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/e të Kushtetutës;
- d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë deri në emërimin e Inspektorit të ri, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 1, nënparagrafët c), ç), d), dhe dh).

4. Pas përfundimit të mandatit, me kërkesë të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kthehet në detyrë që mbante para emërimit ose në një detyrë të përafërt me të.”.

Neni 30

Pas nenit 147/dh shtohet neni 147/e, si vijon:

“Neni 147/e

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
2. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetohen nga një komision hetimor i Kuvendit, duke respektuar të drejtën e tij për proces të rregullt. Komisioni hetimor, në rast se konstaton shkelje sipas paragrafit 2 të këtij neni, i propozon Gjykatës Kushtetuese shkarkimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas ligjit.
4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.”.

Neni 31

Pas nenit 147/e shtohet neni 147/ë si vijon:

“Neni 147/ë

Qenia Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor, sipas ligjit.”.

Neni 32

“Neni 148 ndryshohet si vijon:

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.
2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.
4. Prokuroria e posaçme dhe njësia e posaçme hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, kimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e posaçme hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.”.

Neni 33

Pas nenit 148 shtohet neni 148/a si vijon:

“Neni 148/a

1. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7 vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në një thirrje publike dhe procedurë transparente, përzgjedh dhe rendit tre kandidatët më të kualifikuar dhe ia përcjell Kuvendit, sipas ligjit.
3. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.
4. Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpallet i emëruar.
5. Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit.”.

Neni 34

Pas nenit 148/a shtohet neni 148/b si vijon:

“Neni 148/b

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

- a) Përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme;
- b) Nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme;
- c) Siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së prokurorisë së posaçme. Krijimi dhe mbarëvajtja e strukturave

të teknologjisë së informacionit në prokurori rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) Propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të prokurorisë së posaçme;

d) Raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit;

dh) Ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.”.

Neni 35

Pas nenit 148/b shtohet neni 148/c si vijon:

“Neni 148/c

1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 7 vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës,

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”

Neni 36

Pas nenit 148/c shtohet neni 148/ç si vijon:

“Neni 148/ç

1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj.”.

Neni 37

Pas nenit 148/ç shtohet neni 148/d, si vijon:

“Neni 148/d

1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

- a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.
4. Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur:
- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.”.

Neni 38

Pas nenit 148/d, shtohet neni 148/dh si vijon:

“Neni 148/dh

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135 pika 2 të Kushtetutës si dhe para Gjykatës së Lartë.
2. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ligji vendos kritere të tjera për përzgjedhjen si dhe për procedurën transparente dhe publike të emërimit.
3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të kësaj prokurorie me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje, sipas ligjit.
4. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme shkarkohet për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkelje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Prokurorisë.
5. Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, njësisë së posaçme hetimore, si dhe familjarët e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit.”.

Neni 39

Neni 149 ndryshohet si vijon:

“Neni 149

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve jo prokurorë.
3. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral

dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët jo prokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

4. Dy anëtarë jo prokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit sipas paragrafit 7 të këtij neni.

7. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për mospërbushje të kritereve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

8. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmbledhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

9. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo prokurorë, sipas ligjit.

10. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët prokurorë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Mandati i prokurorit të posaçëm pezullohet gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Anëtarët jo prokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barazvlefshme me to."

Neni 40

Pas nenit 149 shtohet neni 149/a, si vijon:

“Neni 149/a

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:
 - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
 - b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
 - c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
 - ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
 - d) propozon dhe administron buxhetin e tij;
 - dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
 - e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.
2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”.

Neni 41

Pas nenit 149/a shtohet neni 149/b, si vijon:

“Neni 149/b

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbaron kur:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandatin 5 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës;
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas Nenit 149, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.
4. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët c), ç), d) dhe dh) të paragrafit 1 të këtij neni.”.

Neni 42

Pas nenit 149/b shtohet neni 149/c, si vijon:

“Neni 149/c

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
2. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë shkarkohen nga Gjykata Kushtetuese, kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.”.

Neni 43

Pas nenit 149/c shtohet neni 149/ç, si vijon:

“Neni 149/ç

Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor.”

Neni 44

Pas nenit 149/ç shtohet neni 149/d, si vijon:

“Neni 149/d

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mblidhet sa herë është e nevojshme.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë

disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat një vjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës për zgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

5. Krite të tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj.”

Neni 45

Neni 179 ndryshohet si vijon:

“Neni 179

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese sipas mandatit të mëparshëm.

2. Anëtari i parë për t’u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit.

4. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandat tre vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Për emërimet e para për anëtarët jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve

sipas nenit 147 të Kushtetutës do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe dy anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë emërohen fillimisht për një mandat trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjeshme të këtij organi. Për emërimet e para për anëtarët jo prokuror të Këshillit të Lartë Prokurorial që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 149 të Kushtetutës do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.

9. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Mënyra e funksionimit të inspektorateve ekzistuese gjatë periudhës kalimtare rregullohet me ligj.

10. Gjyqtarët dhe prokurorët që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës qëndrojnë në detyrë dhe janë subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas nenit 179/b dhe aneksit të këtij ligji.

11. Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 149/d, pika 3 të Kushtetutës. Nëse Presidenti i Republikës nuk i përzgjedh anëtarët brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Të zgjedhurit qëndrojnë në detyrë deri në datën 31 dhjetor të vitit kur hyn në fuqi ky ligj. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen menjëherë, procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit për gjyqtarë dhe prokurorë sipas nenit 179/b të këtij ligji.

12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij

ligji. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidenti emëron gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 136 të Kushtetutës. Presidenti plotëson vakancën e parë në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe nenit 125 të Kushtetutës.

13. Deri në zgjedhjet parlamentare, që do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se data 1 shtator 2017, zgjedhja e Inspektorit të Lartë Drejtësisë dhe e Prokurorit të Përgjithshëm do të zgjidhen me dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit. Zgjedhjet e tjera do të bëhen me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit.”.

Neni 46

Pas nenit 179/a shtohet neni 179/b si vijon:

“Neni 179/b

1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.
2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.
3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.
4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.
5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjatë periudhës kalimtare 9 vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy Kolegje.
6. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë të pavarur dhe të paanshëm.
7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish gjyqtarë ose ish prokurorë të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit.
8. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit tyre, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit është 9 vjet. Pas shpërbërjes së Komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit.

Çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

9. Kuvendi vendos për shfuqizimin e këtij Aneksi pasi vendimi i fundit të ketë marrë formë të prerë si dhe mbi bazën e raportit të paraqitur nga Kryetari i Apelit mbi gjendjen e çështjeve të papërfunduara, ose kur përfundon mandati i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit.

10. Procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit dhe ligjit.”

Neni 47

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Aneks

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Neni A

Kufizimi i të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta

1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131 shkronja f), 135, 138, 140, 145 paragrafi 1, 147/a paragrafi 1 shkronja b), 149/a paragrafi 1, shkronja b), kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.
2. Subjektet që kalojnë me sukses rivlerësimin sipas parashikimeve të këtij Aneksi i nënshtrohen sistemit të përhershëm të llogaridhënies, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj.

Neni B

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit Euro-Atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Europian.
2. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i ushtron detyrat e veta sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit emëron vëzhguesit ndërkombëtarë pas njoftimit të Këshillit të Ministrave. Vëzhguesit emërohen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse. Mandati i vëzhguesit ndërkombëtar ndërpritet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për shkelje të rënda.
3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra:
 - a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelit dhe Komisionerit Publik;
 - b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit;
 - c) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit.
 - ç) kanë të drejtën të marrin të gjithë informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të

rivlerësimin në të gjitha nivelet dhe fazat.

Neni C

Dispozita të përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga katër trupa gjykes të përhershëm me tre anëtarë secili.
2. Dy Komisionerë Publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit.
3. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, anëtarët e Komisionit dhe Komisionerët Publikë gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mandati i tyre nuk kufizohet për shkak të moshës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.
4. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, Komisionerët Publikë, si dhe punonjësit e tjerë të këtyre institucione nënshkruajnë deklaratë me shkrim sipas ligjit, për të autorizuar kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, monitorimin sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare, si dhe kufizimet e posaçme të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike.
5. Anëtarët e Komisionit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit kanë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe gjyqtarë të Kolegjit nuk duhet të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë gjatë dy vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe funksione drejtuese në parti të politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.
6. Presidenti i Republikës së Shqipërisë organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të Komisionerit Publik. Kandidatët i paraqesin Presidentit aplikimet dhe të gjitha deklaratat shoqëruese, sipas ligjit. Brenda 7 ditëve nga përfundimi i procesit të aplikimit, Presidenti përpilon një listë me kandidatë të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron këtë proces. Nëse Presidenti nuk e përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.
7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët, sipas ligjit. Jo më vonë se katërmbëdhjetë ditë nga paraqitja e dy listave nga Presidenti, Komisioni, bazuar në vlerësimet e tij, i dërgon

rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

8. Brenda tre ditëve nga marrja e listës së kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Kuvendi krijon një komision *ad hoc* me gjashtë anëtarë të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare. Komisioni, me të paktën katër vota, mund të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale tek lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret formale. Komisioni, me të paktën pesë vota, mund kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tek lista e kandidatëve për votim. Brenda dhjetë ditëve nga krijimi i tij, komisioni *ad hoc* i përcjell listën e kandidatëve për votim për secilin pozicion komisioneve *ad hoc* përzgjedhëse. Dy listat e tjera nuk dërgohen për votim.

9. Kuvendi krijon brenda dhjetë ditëve dy komisione *ad hoc* përzgjedhëse të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, ku një komision ka 12 anëtarë dhe një ka 6 anëtarë.

10. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i komisionit *ad hoc*, secili anëtar i komisioni me 12 anëtarë përzgjedh një kandidat për komisioner nga lista e kandidatëve për votim pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni përzgjedh më pas dy kandidatë nga lista e kandidatëve për votim për komisionerë publik përmes një votimi ku dy kandidatët me më shumë vota quhen të përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesit përzgjidhen me short. Dy kandidatë zëvendësues për secilin pozicion përzgjidhen në të njëjtën mënyrë si për komisionerin publik.

11. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i komisionit *ad hoc*, secili prej 6 anëtarëve të komisionit përzgjedh nga lista e kandidatëve për votim një kandidat për gjyqtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni më pas përzgjedh gjyqtarin e shtatë nga kandidatët e mbetur të listës së kandidatëve për votim përmes një votimi të thjeshtë ku kandidati me më shumë vota quhen i përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesi përzgjidhet me short. Dy gjyqtarë zëvendësues për secilin pozicion përzgjidhen në të njëjtën mënyrë si për gjyqtarin e shtatë.

12. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga dy komisionet *ad hoc* përzgjedhëse përmbledhen në një listë të vetme dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve në bllok me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk e miraton listën e kandidatëve në bllok, Kryetari i Kuvendit ia kthen atë komisioneve *ad hoc* për përsëritjen e procesit të përzgjedhjes dhe dërgimin e një listë të dytë brenda 10 ditësh. Kuvendi, brenda 10 ditëve, mund ta rrëzojë në bllok listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në rast se lista nuk rrëzohet, kandidatët e përzgjedhur konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

13. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisioneri Publik ushtrojnë detyrën me kohë të plotë dhe nuk mund të

mbajnë asnjë pozicion apo të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër gjatë kohëzgjatjes së mandatit.

14. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe Komisionerët Publikë kanë buxhet, administratë dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si dhe për ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë, sipas ligjit.

15. Gjuhët zyrtare të Komisionit, të Kolegjit të Apelimit dhe Komisionerëve Publikë janë gjuha shqipe dhe angleze. Të dyja organet punësojnë përkthyes për këtë qëllim.

16. Anëtarit i Komisionit, gjyqtarit i Kolegjit të Apelimit dhe Komisioneri Publik mban përgjegjësi disiplinore. Rastet e shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit, sipas ligjit.

17. Anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit, komisionerit publik, vëzhguesit ndërkombëtar, punonjësit të administratës dhe familjarëve të tyre u garantohet mbrojtje e nivelit më të lartë, sipas ligjit.

Neni Ç Rivlerësimi

1. Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit publikojnë vendimet e tyre si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt.

3. Institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit, duke vënë në dispozicion të tyre informacionin e kërkuar, si dhe duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në të dhënat. Ata mund të japin mendime ose të bëjnë propozime konkrete, sipas ligjit.

4. Komisioni ose Kolegji i Apelimit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, përveç atyre që janë klasifikuar "sekret shtetëror", duke përfshirë edhe dosjet personale të të rivlerësuarit, të dhënat statistikore, dosje të përzgjedhura për rivlerësim, vetëlyerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankimet ndaj të rivlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të rivlerësuarve, të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.

5. Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal.

Neni D **Vlerësimi i pasurive**

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.
2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.
3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.
4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.
5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni DH **Kontrolli i Figurës**

1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.
2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 Janar 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal.
3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni E

Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

2. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi. Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës. Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

3. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit një vjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni Ë

Masat disiplinore

1. Komisioni ose Kolegji i Apelimit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar.
2. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 përqind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi një vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin shkarkohet nga Komisioni.
3. Në çdo rast, shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale.

Neni F **Kolegji i Apelimit**

1. Kolegji i Apelimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjyqëse me pesë anëtarë secili.
2. Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, më përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2 të Aneksit.
3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
4. Vëzhguesi ndërkombëtar në Kolegjin e Apelimit gëzon të njëjtat të drejta si dhe vëzhguesi ndërkombëtar pranë Komisionit.
5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 përqind të pagës. Nëse Kolegji pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 përqind e pagës i paguhet subjektit për të gjithë periudhën e ndërprerjes. Vendimi përfundimtar që urdhëron shkarkimin nga detyra, hyn në fuqi menjëherë.
6. Kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji.
7. Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar. Në rastet e ankimeve nga Komisioneri Publik, Kolegji nuk mund të vendosë një masë disiplinore më të rëndë, pa i dhënë subjektit të rivlerësimit kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u dëgjuar në seancë.

8. Subjektet që rivlerësohet mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni G Dorëheqja

1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.
2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15 vjeçare.